

## STATUT

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

#### “Vala Restaurant” SH.P.K

Në Tiranë, më datë 04 . 10 2023,

Znj. Fiona Çela, e bija e Artur, e datëlindjes 12.06.1998 e lindur në Lezhë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 03087050 dhe nr personal 185612076 Slëshuar me datë 20.04.2016.

ka themeluar shoqërinë tregtare “Vala Restaurnt” sh.p.k, e cila do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqipëtar, Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti, me termat në vijim:

Neni 1

#### **Emërtimi**

1.1 Shoqëria është emërtuar “Vala Restaurant” Sh.p.k.

1.2 Shoqëria është një person juridik Shqipëtar, e cila do të ushtrojë aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë pas Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

#### **Objekti**

2.1 Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë tregëtimi i artikujve të ndryshëm, të të gjitha llojeve, me pakicë si:

- Restaurant
- Bar-Kafe
- Prodhim dhe distribucion I artikujve te ndryshem ushqimore
- Sherbim Catering / Delivery
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
- Tregëtim pije alkolike të ndryshme;
- Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve Brenda dhe jashtë vendit;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafë, loja argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;

2.2 Shoqëria mund ta zgjerojë objektin e veprimtarisë të saj, duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe duke pasqyruar ndryshimet në këtë Statut.



1

Neni 3  
**Selia**

3.1 Shoqëria "Big Vizion" Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: " Rruga Pjetër Bogdani 8/1 , pranë Kopshtit nr.31 , Tiranë ".

3.2 Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, degë, filiale, agjensi, si dhe t'i suprimojë ato.

Neni 4

**Kohëzgjatja e shoqërisë**

4.1 Shoqëria "Big Vizion" Sh.p.k do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar që nga moment I regjistrimit të Niptit në QKB.

Neni 5

**Kapitali i Shoqërisë**

5.1 Znj. Fiona Çela është zotërues I 1 kuote me vlerë **4.000.000 Lekë**, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
FIONA ÇELA	1	100%	4.000.000

5.2 Kuotat e kapitalit janë shlyer tërësisht në të holla nga ortaku themelues.

5.3 Në librat e shoqërisë do të shënohet kapitali i derdhur dhe kuotat e pjesëmarrjes për ortakun.

5.4 Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themelor, dhe të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortaku I shoqërisë.

5.5 Ortaku, në këtë sipërmarrje, ka derdhur kapitalin e tij, me qëllim që të përfitojë të ardhura, që mund të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë private, si dhe të përballojnë humbjet.

5.6 Pjesët e kapitalit themelor janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve e pasardhësve.

5.7 Trashëgimtari hyn në Shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut dhe me të gjitha efektet.

5.8 Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund t'u kalojnë, t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim asambleje të ortakut të shoqërisë dhe me akt noterial.

Neni 6  
**Fitimi**

- 6.1 Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë do të administrohet nga ortaku.
- 6.2 Një pjesë e fitimit mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar.
- 6.3 Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 7  
**Administratori**

- 7.1 Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj. Donalda Dervishi**.
- 7.2 Administratori qëndron në detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 7.3 Mandati i Administratorit mund të jetë i rinovueshëm.
- 7.4 Ortaku gëzon të drejtën në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.
- 7.5 Administratori ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të atribuara vendimarrjes së Asamblesë së Përgjithëshme, në kuptim të ligjit dhe të këtij statuti dhe kufizimeve të vendosura në aktin e emërimit të tij.

Neni 8  
**Viti financiar. Llogaritë vjetore. Detyrime të tjera.**

- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar të çdo viti dhe përfundon më 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.
- 8.2 Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët, apo nga ekspertët kontabël miratohen nga ortaku I vetëm I shoqërisë.
- 8.3 Miratimi i dokumentave financiarë vjetorë bëhet brenda një afati 3-mujor, të mbylljes së vitit financiar.
- 8.4 Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit, shoqëria mund të krijojë dhe fonde të tjera.
- 8.5 Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore etj.
- 8.6 Shoqëria ka të drejtë të çeli llogari likujduese pranë bankave të vendit dhe të kryejë veprime likuidimi me to.



## Neni 9

Ortaku I Vetëm, vendos për çështje si:

- Përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë.
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.
- Emërimin e shkarkimin I likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- Përcaktimin e shpërblimeve
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë

Të gjitha vendimet e mara nga ortaku I vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa kufizuar në të, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- Shpërndarjen e fitmieve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- Investime
- Vendimet oër riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

## Neni 10

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku I vetëm
- Përfaqësojë shoqërinë tregtare
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontrabël të shoqërisë
- Përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- Raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare



Neni 11

**Likujdimi i shoqërisë**

- Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, emërohet një nga disa likujdatorë të cilët ndjekin operacionet e likujdimit deri në fund dhe i paraqesin ortakut dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likujdimit. Në përfundim Asambleja e Përgjithëshme vendos për heqjen e mandatit të tyre.
- Asambleja e Përgjithëshme do të vendosë për mënyrën dhe modalitetet e shlyerjes së detyrimeve që dalin nga procesi i likujdimit.

Neni 12

**Ndryshimet në statut**

- Ortakët e Shoqërisë mund të bëjnë, në çdo kohë, ndryshime e plotësime në Statut dhe në aktin e themelimit, pa rënë ndesh, në mënyrë thelbesore, me nenet e përshkruara në këtë Statut.
- Ndryshimet e plotësimet, në këtë statut, bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurëme të cilën nxirret vetë statuti.

Neni 12

**Ligji i zbatueshëm**

Për çështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë statut, gjithçka i referohet ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, legjisacionit shqipëtar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Ky statut është përpiluar dhe firmosur në tre kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.



Datë 04/10/2023

ORTAKËT THEMELUES

Znj. Fiona Çela

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, stylized letter 'F' with a horizontal line extending to the left and a vertical line extending downwards, crossing the horizontal line.A smaller handwritten signature in blue ink, similar in style to the one above, with a horizontal line extending to the left and a vertical line extending downwards, crossing the horizontal line.